



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE NË KOSOVË INSTITUCIJE PRIVREMENE SAMOUPRAVE NA KOSOVO PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT OF KOSOVO		
QEVERIA E KOSOVËS Ministria e Shëndetësisë	GOVERNMENT OF KOSOVO Ministry of Health	VLADA KOSOVA Ministarstvo zdravstva

Udhëzimi Administrativ (Shëndetësi) Nr. 09/2007

Për Zbatimin e Fletores për Shtatzëna dhe të

Fletores së Shëndetit të Fëmijës

Ministria e Shëndetësisë,

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK 2001/9 “Mbi Kornizën Kushtetuese të Kosovës”, Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19, “Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë”, Rregulloren e UNMIK-ut 2005/15 “Për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë”,

Bazuar në Ligjin Për Shëndetësi Nr.2004/4 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/31, neni 11 paragrafi 1, neni 17 paragrafi (c), neni 19 paragrafi 1 nënparagrafi (a) dhe (c), neni 20 paragrafi 1, neni 64 dhe neni 102,

Në pajtueshmëri me Ligjin për Shëndetin Riprodhues Nr.02/L-76 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2007/11, neni 9 paragrafi 2,

Me qëllim të vënies së bazës ligjore për zbatimin e Fletores për shtatzëna dhe Fletores së shëndetit të fëmijës, nxjerr:

Udhëzimin Administrativ Për Zbatimin e Fletores për Shtatzëna dhe Fletores së Shëndetit të Fëmijës.

Adresa Postare / Postal Address / Poštanska Adresa Ministria e Shëndetësisë, Rruga e Zagrebit PN- Prishtinë	Telephone: 0 38-212-314	Fax: 038-212-211
--	-------------------------	------------------



Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim administrativ ka për qëllim të rregulloj në mënyrë unike shpërndarjen, përdorimin, mbajtjen dhe shënimin e të dhënave në Fletoren për shtatzëna dhe Fletoren për shëndetin e fëmijës.

Neni 2

Përpilimi dhe shpërndarja e Fletores për shtatzëna dhe

Fletores së shëndetit të fëmijës

- 2.1 Fletorja për shtatzëna dhe Fletorja e shëndetit të fëmijës janë dokumente të hartuara nga Komiteti Kosovar për Shëndetin e Nënës dhe të Fëmijës, trup i themeluar nga Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me Shoqatën e Gjinekologëve dhe Obstetërve të Kosovës dhe Shoqatën e Pediatërve të Kosovës, duke u bazuar në standardet dhe normat e aprovuara nga Ministria e Shëndetësisë të harmonizuara me standardet ndërkombëtare.
- 2.2 Komiteti bën rivlerësimin e fletoreve çdo të dytin vit dhe e ndryshon sipas nevojës.
- 2.3 Fletoret për shtatzëna dhe Fletoret për shëndetin e fëmijës përmes institucioneve përkatëse shpërndahen dhe u jepen në shfrytëzim shtatzënave, përkatësisht fëmijëve deri në moshën 18 vjeçare.
- 2.4 Shpërndarja bëhet nga ana e institucioneve shëndetësore publike qysh në vizitën e parë të shtatzënës apo në dalje të foshnjës nga lindorja dhe atë:
 - a) fletorja e shtatzënës shpërndahet nga maternitetet ose këshillimoret për shtatzëna në kuadër të Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare,
 - b) fletorja e shëndetit të fëmijës shpërndahet nga maternitetet pranë Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe ato spitalore të nivelit dytësor dhe tretësor.
- 2.5 Fletoret për shtatzëna dhe Fletoret për shëndetin e fëmijës u jepen falas në shfrytëzim shtatzënave, përkatësisht fëmijëve në momentin e vizitës së parë në institucionin shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor.
- 2.6 Fletoret për shtatzëna dhe Fletoret për shëndetin e fëmijës janë fletore personale që mbeten në pronësi të shfrytëzuesit.

Neni 3

Plotësimi i Fletoreve

- 3.1 Mbajtja dhe shënimi i të dhënave në fletore bëhet nga punëtori shëndetësor mjeku i lëmisë përkatëse, mamia, infermieri i punësuar në institucionin shëndetësor.
- 3.2 Mbajtja dhe shënimi i të dhënave në fletore duhet të jetë i saktë, i qartë, i lexueshëm dhe me të gjithë parametrat e shënuar dhe kërkuar.
- 3.3 Mosmbajtja dhe shënimi i të dhënave në fletore nga punëtori shëndetësor bie ndesh me obligimet nga marrëdhënia e punës.

Neni 4

Kartela e imunizimit

- 4.1 Kartela e imunizimit e cila është në përdorim, do të jetë e panevojshme nëse të dhënat e kërkuara mbi imunizimin shënohen në fletoren e shëndetit të shtatzënës dhe të fëmijës.
- 4.2 Diagnoza ose sëmundjet e konstatuara gjatë vizitës së rregullt duhet të shënohen në vendin përkatës në fletore.

Neni 5

Roli edukativ, promovues dhe arsimor

- 5.1 Fletorja për shtatzëna dhe Fletorja për shëndetin e fëmijës ofron njohuri me ndikim edukimi e arsimimi shëndetësor, në dobi të ngritjes së aftësive në përparimin dhe përmirësimin e shëndetit të këtyre kategorive.
- 5.2 Fletorja për shtatzëna dhe fletorja për shëndetin e fëmijës siguron edhe evidencë shëndetësore duke i grumbulluar dhe ruajtur të dhënat personale të shfrytëzuesit të fletores.

Neni 6

E drejta në informata

Shfrytëzuesi përmes Fletores për shtatzëna dhe Fletores për shëndetin e fëmijës realizon të drejtën për informacion të plotë mbi zhvillimin dhe shëndetin.

Neni 7

Obligimet dhe mbikëqyrja

- 7.1 Komiteti harton, revidon dhe mbikëqyrë shpërndarjen, mbajtjen dhe shënimin e të dhënave të Fletores për shtatzëna dhe Fletores për shëndetin e fëmijës.
- 7.2 Ministria e Shëndetësisë përmes fondeve të saj siguron mbulimin e shpenzimeve që lidhen me shtypjen dhe revidimet e Fletores për shtatzëna dhe Fletores për shëndetin e fëmijës.
- 7.3 Inspektorati shëndetësor siguron dhe mbikëqyrë kontrollin e jashtëm lidhur me zbatimin e Fletores për shtatzëna dhe Fletores për shëndetin e fëmijës.
- 7.4 Institucionet shëndetësore dhe punëtorët shëndetësor sigurojnë zbatimin dhe kontrollin e brendshëm të përdorimit, mbajtjen dhe shënimin e të dhënave të Fletores për shtatzëna dhe Fletores për shëndetin e fëmijës.
- 7.5 Në rast të moszbatimit të dispozitave të këtij udhëzimi administrativ do të ndërmerren masat përkatëse ndëshkimore ndaj institucionit, drejtorit dhe punëtorëve shëndetësor sipas nenit 3.1 të këtij udhëzimi administrativ.



- 7.6 Obligohen të gjitha institucionet shëndetësore dhe punëtorët shëndetësor për mbajtjen dhe shënimin e të dhënave në Fletoren për shtatzëna dhe Fletoren e shëndetit të fëmijës.
- 7.7 Obligohen shtatzënat, përkatësisht prindërit e fëmijëve që me rastin e çdo vizite te mjeku , të posedojnë Fletoren për shtatzëna përkatësisht Fletoren e shëndetit të fëmijës.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Prishtinë
23.11.2007



Sadik Idrizi
Sadik Idrizi
Ministër i Shëndetësisë

